

Preporrt - Operatori i katërt në telefoninë mobile në Shqipëri është marrë në emër të PTK-së. Pasi e proklamuan si një projekt që do të ndryshojë praktikën e nxjerrjes së parasë jashtë vendit nga ky sektor shumë profitabil, kryeministrat, Berisha e Thaçi, morën përsipër që në mënyrë indirekte të ndërtonjë një operator të përbashkët në telefoninë mobile. Më pak se një vit nga fillimi i punës së këtij operatori u bë e qartë se PTK u shfrytëzua vetëm si emër për të shtuar pikët në tenderin për operatorin e katërt.

Tenderi që ekspozoi

Ku ishte sikleti i vërtetë i qeverisë kur po bënte presion në Kuvend për Strategjinë për privatizimin e PTK-së? Kush janë kompanitë e individët që kontrolluan procesin e përgatitjes dhe hedhjes në privatizim të PTK-së, që prej vitit 2007?

Preportr - Tenderi për shitjen e PTK-së ka dështuar, pasi që Hrvatski Telekom ka qenë i bindur që fitues i tenderit për blerjen e PTK-së në fund do të dalë Telekom Austrian AG. Kjo kompani ka ikur nga gara pasi e ka parë tendencën e qeverisë që me çdo kusht PTK-në t'ia jap Telekom Austrian AG. Ikja e Hrvatski Telekom nga gara ka bërë që tenderi për shitjen e PTK-së të dështojë në fazën e para-kualifikimit. Tenderi për shitjen e PTK-së ka dështuar pasi që qeveria është munduar të përm-bushë kërkesat e kompanisë që ka një histori në tregun e telekomunikimit në Kosovë, Telekom Austrian AG. Më 2007, Telekom Austrian AG, ka qenë njëri prej pretendentëve për ta fituar licencën për operatorin e dytë të telefonisë mobile në Kosovë. Pasi humbi garën për të marrë licencën për telefoninë e dytë mobile, kjo kompani ndërmori nisma ligjore kundër autoriteteve të Kosovës, për shkak të shkeljeve të procedurave të tenderimit. Prej atëherë e deri më tani, ky rast i paraqitur nga Telekom Austrian AG, asnjëherë nuk është shqyrtuar nga drejtësia. Në atë kohë, si përfaqësues i Austrian Telekom AG në Kosovë, për ta fituar licencën e operatorit të dytë të telefonisë mobile, ka qenë pikërisht këshilltari i qeverisë për privatizimin e PTK-së, Tibor Kartik nga Telco AG dhe Wolf Theiss.

Ky hulumtim i "Preportr" tregon se tërë procesi i përgatitjes së bazës për këtë privatizim si dhe vetë tenderi ishin të njëanshme dhe të orientuara drejt një qëllimi të krijuar që në vitin 2007. Qeveria ka pasur për synim që PTK-në t'ia jap si monedhë kusuri Telekomit Austriak, këshilltarët e së cilës e kanë kontrolluar këtë proces qysh nga fillimi.

Pse u largua "Hrvatski Telekom" nga gara?

Meqë largimi i Hrvatski Telekom d.d qoi në kolaps automatik tenderin për shitjen e PTK-së, arsyet pse sollën këtë kompani deri tek ky vendim ishin shumë të rëndësishme për publikun. Në disa prononcime për media, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj ka thënë që arsyeja kryesore e tërheqjes së Hrvatski Telekom është dështimi i kësaj kompanie, gjegjësisht principalit të saj



Deutsche Telecom, që të shesë aksione në Amerikë.

Vetë kompania, në anën tjetër, jep një arsytim tjetër zyrtar. "Arsyet pse po largohemi janë akuzat për korrupsion ndaj menaxhmentit të PTK-së", thonë zyrtarisht nga Hrvatski Telekom. "Ne kemi deklaruar se T-HT është duke e shqyrtuar pjesëmarrjen e saj në procesin e privatizimit për shkak të akuzave ndaj menaxhmentit të PTK-së, të dyshuar për korrupsion", kanë thënë zyrtarët e telekomit kroat për Preportr.

Mirëpo, persona të afërt me përfaqësuesit e kroatëve në Kosovë, kanë bërë me dije se prej përgatitjes së raportit nga këshilltari i transaksionit Telco AG dhe përparësisë indirekte që i ka dhënë qeveria Telekomit Austriak, ka bërë që Hrvatski Telekom të largohet nga gara. Në një incizim, të siguruar nga Preportr, të një bisede private mes drejtorit të PTK-së, Shyqyri Haxha dhe Sinisha Gjyranoviq, zyrtar pranë telekomit Kroat, të dyja palët flasin për arsyet e largimit nga gara të operatorit kroat. Haxha ka kërkuar sqarim nga ata nëse kanë thënë se menaxhmenti është i korruptuar, duke e vlerësuar si deklaratë që mund t'i shkaktojë dëm sidomos në prag të procesin gjyqësor të nisur kundër tij.

Ndërkohë, që përfaqësuesi kroat thotë se ata kanë kërkuar rreth dy muaj më parë nga Qeveria që ta pezullojë procesin derisa të sqarohet çështja e akuzave ndaj menaxhmentit të PTK-së për korrupsion. "Nuk kemi deklaruar se ju jeni të korruptuar asnjëherë, por kemi thënë që duhet ndërprerë njëherë procesi derisa të sqarohen dyshimet dhe akuzat, ne nuk e kemi ditur se do të mbahet se-

ancë gjyqësore dhe nuk kemi pasur asnjë qëllim që t'ju shkaktojmë problem, ne nuk duam të paragjykojmë", i ka thënë përmes telefonit Gjyranoviq, drejtorit të PTK-së Haxha.

Nga kjo bisedë telefonike mësohet se kroatët kanë kërkuar nga Qeveria pezullimin e procesit të shitjes së PTK-së, por përkundër këtyre kërkesave, është vazhduar me procesin e privatizimit të PTK-së, deri sa Hrvatski Telekom zyrtarisht tërhiqet nga gara.

Burimet nga Hrvatski Telekom thonë se arsyeja e vërtetë e dështimit të privatizimit të PTK-së ka të bëjë me dyshimet se procesi i shitjes së kësaj kompanie ka qenë i kurdur dhe për këtë, Hrvatski Telekom është tërhequr nga gara. "Hrvatski Telekom e ka parë tendencën që Qeveria është duke e përkrahur Telekom Austria me faktin që Këshilltari i Transaksionit më 2007 ka qenë përfaqësues i Telekom Austria për tenderin e dytë të telefonisë mobile, dhe po i njëjti ka qenë i angazhuar nga Qeveria si Këshilltar për privatizimin e PTK-së", thotë për Preportr në kushte anonimiteti, një përfaqësues i Hrvatski Telekom.

Para-kualifikimi si pararojë e dështimit

Në fund të vitit të kaluar, qeveria bëri përzgjedhjen e pesë kompanive për të garuar për fazën e para-kualifikimit në tenderin për shitjen e PTK-së: "AlbTelecom" Sh.A nga Shqipëria (shumica e aksioneve janë në pronë të "Calik Group" dhe "Turk Telekom"), "Hrvatski Telekom" d.d. (HT), nga Kroacia (shumica e aksioneve të HT janë në pronë të "Deutsche Telekom"), "Orascom Telecom Holding" S.A.E. nga

Egjipti, "Telekom Austria" AG nga Austria dhe "Sabafon" nga Jemeni. Disa muaj më vonë, më 2 qershor të këtij viti, u eliminuan tri kompani dhe mbetën vetëm dy në garë, "Telekom Austria AG" dhe "Hrvatski Telekom d.d.", dhe nga qeveritarët u deklarua se procesi përfundoi me sukses. "Komisioni Qeveritar për Privatizim, e vlerëson shumë të suksesshme këtë fazë të para-kualifikimit për shitjen e aksioneve të PTK-së", thuhet në komunikatën e MZHE të lëshuar në qershor. Ministria e Zhvillimit Ekonomik kishte lëshuar po ashtu një komunikatë më 20 Qershor në të cilën thuhet se: "Procesi i privatizimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës është duke u zhvilluar sipas strategjisë dhe planit të paraparë, bazuar në dispozitat ligjore dhe me transparencë të plotë".

Kështu u vendos që tenderi të vazhdohej, dhe as Qeveria, por as mekanizmat tjerë të përfshirë në këtë proces, nuk e nxorën as më të voglin dyshim, deri sa Këshilltari i Transaksionit e dorëzoi raportin e parë të vlerësimit të PTK-së për aksionarin, pra Qeverinë. Burimi i Preportr, tregon që me rastin e daljes në publik të raportit të vlerësimit të PTK-së nga Telco AG, në korrik të këtij viti, procesi i privatizimit të PTK-së hyn në ujëra të turbullta. "Me daljen e raportit të vlerësimit të Këshilltarit të transaksionit, si dhe duke pasur parasysh lidhjet e këshilltarit, Tibor Kartik, me Telekom Austria, është bërë e qartë se kush i ka gjasat që ta fitojë tenderin", ka thënë për "Preportr", një burim i afërt me operatorin kroat. Ky raport nxiti debat në mes të drejtorit të PTK-së, Shyqyri Haxha, dhe Këshilltarit të Transaksionit, Tibor Kartik, ku ky vlerësim i PTK-së u quajt si tendencë për dëmtimin e PTK-së.

kapjen e qeverisë

Qeveria duke parë rrezikun se Hrvatski Telekom mund të tërhiqet nga gara, gjë që do sillte dështimin e tenderit, në shtator vendosi të shtyjë fazën e para-kualifikimi edhe për dy javë, duke i dhënë mundësinë, për herë të dytë, kompanive që vetëm tre muaj më parë ishin diskualifikuar për mospërbushje të kriterëve të futet sërish në garë. “Ky vendim (i Komitetit për privatizim) është marrë me qëllim të arritjes së një niveli më të lartë të konkurrencës në proces, duke pasur kujdes gjithnjë sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe fer të të gjitha kompanive pjesëmarrëse në këtë proces”, thuhet në komunikatën e lëshuar të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik më 2 shtator të këtij viti.

Mirëpo, si u bë që në Qershor, qeveria të deklarojë dy herë që gjithçka me tenderin është në rregull dhe papritmas në Shtator të vendosë të shtyjë fazën e para-kualifikimi edhe për dy javë dhe kështu t’iu jap një mundësi të re kompanive, që i kishte diskualifikuar në Qershor, të marrin prapë pjesë në tender.

Nga kjo perspektivë, del se Qeveria mund të ketë pasur indikacione se njëri nga ofertuesit e para-kualifikuar, Hrvatski Telekom d.d mund të tërhiqet, dhe për pasojë, shpërblimi i Telekom Austria, si fitues i tenderit do të bëhej i pamundur. Në një intervistë për “Preportr”, të dhënë nga ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, MIMOZA Kusari-Lila, qysh në fillim të tetorit, kur në atë kohë nga autoritetet publikisht ende flitej për një proces tërësisht normal dhe pa probleme të tenderimit, ministrja kishte lënë të hapur mundësinë që tenderi për privatizimin e PTK-së edhe mund të dështonte. “Në fazën ku është, ky si proces mund edhe mos të realizohet. Po e shohim se ka vonesa, ka mundësi të ndryshimit të gjendjes së ofertuesve, është diçka shumë reale për shkak të situatës së përgjithshme ekonomike evropiane” pat thënë ministrja Kusari për Preportr.

Favorizimi i Telekomit

Austriak AG

Në të vërtetë, ndikimi i fortë i Telekom Austria AG tek autoritetet vendim-marrëse në procesin e privatizimit të PTK-së, ka qenë shumë evident edhe më herët. Drejtori aktual i PTK-së, Shyqyri Haxha, thotë në një intervistë për “Preportr” se ka qenë kërkesë e përfaqësuesit të Telekom Austria, në një konferencë të donatorëve në Prishtinë, në Mars të vitit 2010, që të anulohet nga ish-ministri Ahmet Shala një kontratë e rëndësishme e PTK-së, përkatësisht kontrata me Amdocs për platformën e faturimit. Sipas zyrtarëve të PTK-së, anulimi i kësaj kontrate dhe rrjedhimisht i sistemit të faturimit nga

qeveria, ka shkaktuar një disfavor të jashtëzakonshëm për këtë kompani dhe e ka kufizuar atë në përballimin e konkurrencës me operatorë tjerë.

Zyrtarë të lartë në PTK-së deklaruan për Preportr se qëllimi i vërtetë i ndaljes së këtij projekti si dhe projekteve tjera kapitale, siç është projekti për fibrat optik apo edhe faza e gjashtë e zgjerimit të kapaciteteve, ka qenë devaluimi i vlerës së PTK-së në prag të privatizimit me një qëllim të vetëm, shitjen e saj sa më lirë. “Ju them sinjerisht dhe me përgjegjësi të plotë se qëllimi i vërtetë i ndaljes së këtyre projekteve ka qenë devaluimi i vlerës së PTK-së në prag të privatizimit”, thotë ky zyrtar i lartë në PTK. Madje ky zyrtar pranon se ka pasur edhe një konflikt verbal me përfaqësuesit e Telekom Austrian AG rreth çështjes së sistemit të faturimit. “Në sy i kam thënë përfaqësuesve të Telekom Austrian, se ju nuk mund të diktoni investimet në PTK-së”, thotë burimi i Preportr në PTK.

Një marrëdhënie shumë e çuditshme mes privatizimit të PTK-së dhe të dy kompanive që kanë këshilluar qeverinë për këtë privatizim, na e zbulon vetë profili i kompanisë këshillëdhënëse të Qeverisë, Wolf Theiss. Në këtë profil, krahas shumë punëve të kryera nga kjo kompani për AKM, Qeveri dhe PTK, shfaqet edhe një aktivitet i kësaj kompanie në iniciimin e procedurave kundër autoriteteve kosovare për shkak të shkeljeve në tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile në vitin 2007 nga ART-ja.

Wolf Theiss, e angazhuar për këshillim në privatizimin e PTK-së, ka qenë po ashtu këshilltar e Telekom Austria AG në tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile. Në profilin e Kompanisë thuhet, “pasi që tenderi nuk pati sukses, Wolf Theiss ka iniciuar një numër kontestesh rreth procedurave të tenderit në disa gjyqe dhe institucione të Kosovës”.

Kjo marrëdhënie dhe fakti që Telekom Austria AG, e përfaqësuar dikur nga Wolf Theiss dhe Telco AG, ishte pretendentja kryesore në blerjen e PTK-së, krijoi potencial për një tender të shitjes së kompanisë më fitimprurëse kosovare nën kushte të një konflikti interesi që cenoi seriozisht qeverisjen e mirë të privatizimit të PTK-së.

Kontratën për ta këshilluar Qeverinë për privatizimin e PTK-së, ish-përfaqësuesi i Telekom Austrisë, Tiborg Kartik, e ka marrë në konzorcium me një kompani tjetër që në Kosovë kanë qenë ujqër të vjetër. Wolf Theiss që angazhuar në shumë projekte tjera nga AKM-ja në kohën kur ajo kishte për drejtor të zyrës, Ahmet Shalën. Si ministër i Ekonomisë dhe Financave, Shala e përfshiu sërish

këtë kompani në Privatizimin e PTK-së, kësaj here bashkë me Tiborg Kartik, ish-përfaqësues i kompanisë Telekom Austria AG në tenderin për operator të dytë të telefonisë mobile në Kosovë.

Në profilin e kompanisë Wolf Theiss, të botuar në dhjetor 2010, tregohet sa e përfshirë ka qenë kjo kompani në Kosovë në sektorin e ekonomisë, ku për një kohë të gjatë mbretëronte emri i ish-ministrit Shala.

Siç shihet, Wolf Theiss, praktikisht ka qenë prezent në Kosovë në sektorët në të cilët ka udhëhequr ish-ministri i ekonomisë dhe ish-drejtori i AKM-së, Ahmet Shala. Kjo kompani, së bashku me Telco AG, janë angazhuar sërish nga i njëjti person për ta këshilluar qeverinë në privatizimin e PTK-së, duke injoruar faktin se ata kanë qenë të afërt me njërin nga ofertuesit kryesor, Telekom Austria, si e vetmja kompani e ngulur deri në fund të procesit për blerjen e PTK-së.

Raporti që zhvlerësoi

PTK-në kundërshtohet nga

menaxhmenti i kompanisë

Në një raport të bërë nga Këshilltari i Transaksionit, pasuria e PTK-së vlerësohet vetëm 110 milionë euro. Ky raport është kundërshtuar nga menaxhmenti i PTK-së dhe nga Bordi i saj, por është mbrojtur nga ministri i zhvillimit ekonomik, Besim Beqaj, në një intervistë dhënë RTK-së në nëntor të këtij viti.

Wolf Theiss ka këshilluar autoritetet kosovare në këto projekte:

- Këshillimi i Qeverisë së Kosovës në privatizimin e PTK-së
- Këshillimin e AKM-së në shitjen e aksioneve në Bankën e Re të Kosovës dhe në Kasabankë/Nova Ljubljanska Banka
- Këshillimin e AKM-së dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës në kalimin e Aeroportit në shoqëri aksionare
- Këshillimin e Agjensionit Evropian për Rindërtim për KEK
- Këshillimin e Mobilcom Austria AG në tenderimin e saj për operatorin e dytë për licencë GSM
- Këshillimin e AKM-së për rekonstruktimin e hekurudhave
- Këshillimin e AKM-së dhe PTK-së në prokurimin publik për rrjetin GSM
- Ushtrues i rolit të një nga tre kompanitë e preferuara për AKM dhe të gjitha ndërmarrjeve të menaxhuara nga ajo.
- Këshillimi i PTK-së në standardet ndërkombëtare në lidhje me tretmanin e barabartë dhe eksproprium në kontekstin e taksave

Në raport të Telco AG mbi vlerën e PTK-së, flitet për konfliktet e krijuara mes PTK-së dhe kompanive që ka angazhuar menaxhmenti dhe qeveria për projekte të ndryshme si kërcënim serioz të vlerës së kompanisë. Kontrata me problematike shihet ajo me kompaninë Amdocs, cilës në prill të vitit 2010, i është dhënë një tender për ndërtimin e një platforme faturimi, por që është anuluar nga ish-ministri Shala vetëm disa ditë pas nënshkrimit të saj.

Anulimi i kësaj kontrate ishte kërkuar nga Telekom Austria AG, në një konferencë në mars të vitit 2010. Amdocs tashmë ka krijuar një rast për këtë çështje dhe sipas raportit të bërë nga vetë këshilltari i qeverisë, gjasat janë që ky anulim t’i kushtojë PTK-së aq sa ka qenë vlera e projektit, pra 20 milionë euro.

Përndryshe, anulimi i këtij projektit, sipas drejtorit menaxhues të PTK-së, Shyqyri Haxha, ka zhvlerësuar PTK-në në masën prej 20% qysh në momentin e anulimit, por që ka pasur pasojë edhe më të rënda për shkak të pamundësisë të PTK-së që të përballojë konkurrencën e operatorëve tjerë.

Vazhdojnë me avazin e

vjetër

Tani që tenderi ka dështuar, qeveria planifikon ta përsëris tenderin për shitjen e PTK-së me bazë të njëjtat dokumente të përpiluara deri më tani.

Sipas deklarimeve zyrtare, të zyrës për informim të ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, procesi i privatizimit të PTK-së, kurdo që të fillojë, do të ketë për bazë dokumentet dhe raportet e prodhuara deri më tani. “Deri tani janë analizuar mijëra dokumente dhe janë përgatitur dokumente tenderuese e raporte me një vëllim prej mbi 3000 faqesh dhe ato do të përdoren kurdo që të rifillojë procesi i ri”, kanë thënë nga zyra për informim e MZHE-së. Po ashtu, Qeveria nuk planifikon të nxjerrë ndonjë vendim të ri për privatizimin e PTK-së, para Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke e konsideruar nënin 4 të Ligjit për Buxhetin e viti 2011, si bazë të mjaftueshme ligjore për të vazhduar me një tender të ri. Ata konfirmojnë se, edhe pse Ligji për Buxhetin 2011, në kuadër të të cilit është kaluar Strategjia për Privatizimin e PTK-së dhe marrë vendimi për shitje, skadon në fund të këtij viti, procesi i privatizimit të PTK-së do të vazhdojë pa asnjë ndryshim.

“Jemi konsultuar edhe me jurist vendorë dhe ndërkombëtarë, strategjia dhe baza ligjore mbetet e njëjta”, ka thënë për Preportr, Ministri për Ekonomi dhe Financa, Bedri Hamza.

Tregu i lirë me kokë teposhtë



Kush e solli Dardafonin? Kontrata që hyri si pykë përçarjeje mes aksionerëve të Dardafonit, menaxhmentit dhe Bordit të PTK-së. Si po shihet Zmobile si mjet i PTK-së për ta luftuar konkurrencën e IPKO-s dhe D3-it.

Preportr – Padia rreth kontratës mes PTK-së dhe Dardafone.net (ish-Dardafone) është në prag të konfirmimit për së paku katër persona. Derisa të implikuarit konsiderojnë se kjo kontratë nuk e ka dëmtuar PTK-në, ata njëkohësisht përpiqen t'i hedhin fajin njëri-tjetrit.

Fjala është për kontratën e operatorit virtual të telefonisë mobile, e ashtuquajtur MVNO, e cila në princip shfrytëzon infrastrukturën e operatorit publik "Vala900". Por ky operatorë virtual ofron shërbime për konsumatorët në llogari të një kompanie private, Dardafone.net, që është në pronësi të familjes Devolli nga Peja, gjegjësisht Devolli Company. Kjo kontratë ka vendosur që kompania që tani funksionon me emrin komercial "Z-Mobile", të marrë 73% të të hyrave, derisa 27% i ngelen PTK-së. Kontrata është kritikuar sidomos për raportin tepër të favorshëm për Dardafon.net.

Dokumentet më të hershme rreth idesë së MVNO-së, të siguruar nga Preportr, datojnë nga mesi i viti 2006, kohë kur menaxheri i PTK-së ishte Etrur Rustemaj. Në gusht të vitit 2008, një marrëveshje parimore me Dardafon LLC e ka nënshkruar pasuesi i Rustemajt, Adnan Merovci. Marrëveshja u finalizua nga nënshkrimi i drejtorit aktual Shyqyri Haxha, por tani me një kompani që kishte ndërruar emrin duke u shndërruar nga Dardafone LLC në Dardafone.net.

Ky shndërrim i identitetit të kompanisë është aktualisht duke u konsideruar si joligjor nga Prokuroria Speciale e Kosovës, e cila ka akuzuar Haxhën dhe kryetarin e Bordit të PTK-së, Rexhë Gjonbalaj se kanë marrë pjesë në falsifikimin e emrit të kësaj kompanie. Kur i është ndërruar emri dhe numri i biznesit, aksionarët aktual të Z-Mobile, Blerim e Shkëlzen Devolli, kishin arritur një marrëveshje me aksionarin tjetër, Adrian Shatku, që t'i paguajnë atij aksionet. Në disa relacione të shkruara gjatë viteve 2009/2010, përfaqësuesit ligjor të Adrian Shatkut kanë kërcënuar Haxhajn e Gjonbalajn se do të ndërmarrin aksione kundër të dyve në rast se injorojnë faktin se ish-bashkëpunëtorët e Shatkut, vëllezërit Devolli, nuk paguajnë aksionet ashtu siç ishin marrë vesh me Mar-

rëveshjen e Shitjes së Aksioneve. Shatku ka kërcënuar me një kërkesë ligjore që do t'i kushtojë PTK-së dhjetë milionë euro (10,000,000). Sido që të jetë, më 3 shtator 2009, në evidencat që posedon "Preportr", thuhet se "Devolli Group" i ka paguar UNIFI-it, gjegjësisht kompanisë amerikane të themeluar nga Adrian Shatku dhe disa të tjerë, 700 mijë euro.

UNIFI kishte vazhduar edhe pas kësaj pagese të kërkonte transfere shtesë nga Devolli dhe kjo shihet në komunikimet e përfaqësuesit të tyre ligjor dhe krerëve të PTK-së, Gjonbalaj e Haxha. Shatku, madje kishte përdorur edhe Ambasadën Amerikane në Prishtinë për të ndikuar tek krerët e PTK-së në marrjen e masave ndaj Devolli Group, në mënyrë që transferet e dëshiruara të ndodhin. "Keni injoruar vërejtjet e Ambasadës Amerikane" thuhet në një letër dërguar nga përfaqësuesi i UNIFI dhe UNITEL në adresë të Rexhë Gjonbalajt, më datën 28 korrik 2008.

Fshehën të ardhurat

Shërbimi që ofrohet nga Dardafon.net, nën emrin "Z-Mobile", me kontratë valide ka në dispozicion 200 mijë numra mobil. Ajo po ofron numra që fillojnë 377 45, njëjtë sikur edhe Vala, me ndryshimin se numrat pasues të Z-mobile fillojnë me 5 apo 6. PTK-ja deri tash ia ka dorëzuar operatorit mobil virtual 150 mijë numra, nga të cilët mbi 120 mijë tashmë janë aktiv, ndërsa nga përqindja e të hyrave të parapara me kontratë, PTK-së gjatë vitit 2010, i kanë takuar afër 550 mijë euro. Me 150 mijë numra shtesë, fitimi i mundshëm i operatorit "Vala" do të ishte shumë më i madh.

Drejtori komercial në "Z Mobile", Burim Krasniqi, thotë se në bazë të kontratës së nënshkruar, për një vit të operimit të "Z Mobile" në treg, PTK-ja vetëm nga përqindja e ndarjes së të hyrave i ka marrë 548 mijë euro, ndërsa mbi 1.4 milionë euro të tjera i ka fituar nga thirrjet e realizuara nga konsumatorët e Vala-s në "Z Mobile". Sido që të jetë, ky pretendim bie kur kihet para sysh se ky 1.4 milionë euro do të realizohej me të njëjtin trafik edhe nëse thirrjet

nga "Vala" do bëheshin në ndonjë operator tjetër.

Ndonëse nuk heziton t'i bëj publike fitimet e operatorit "Vala" nga "Z Mobile", Krasniqi nuk i zbulon se sa kanë qenë të hyrat dhe fitimet e "Z Mobile" gjatë vitit të kaluar, me arsyetimin se ende "nuk janë audituar pasqyrat financiare".

Mirëpo po u bë një kalkulim i thjeshtë del se nëse PTK i ka marrë rreth 548 mijë euro nga vetëm 27% e të hyrave që i takojnë në kontratë, atëherë fitimet e "Z Mobile" kanë qenë afër 1.5 milionë euro nga 73% për qind e të hyrave që i takojnë me kontratë. E nëse llogariten edhe thirrjet e realizuara nga "Z Mobile" në "Vala", atëherë fitimet e operatorit mobil virtual janë edhe miliona euro të tjera.

Kontrata me "Z-Mobile" po konsiderohet e dëmshme edhe nga Prokuroria Speciale, e cila ka ngritur aktakuzë kundër dy drejtuesve kryesorë të saj, sepse sipas prokurorëve, "Kjo kontratë e bën kompaninë 'Dardafon' të privilegjuar dhe konkurrente të PTK-së". Madje kjo kontratë ia lejon "Z-Mobile" që të konkurrojë në tenderë publik të njëjtë me PTK-në, në të cilat kryesisht del fituese e privileguara, pra "Z-Mobile".

Mungesa e sistemit të faturimit arsyetim për kontratën me Z-Mobile

Në disa tenderë publik, Z-Mobile i ka marrë konsumatorë PTK-së. Një privilegj të tillë nuk e gëzon operator tjetër vir-


tual "D3 Mobile". Kontrata e nënshkruar në mes të këtij operatori dhe "IPKO-s" ia ndalon që të ofertojë në tenderë. Kompania "Dardafone.net" që operon me emrin tregtar "Z-Mobile" i ka marrë "Valës" klientë nga institucionet shtetërore.


Doganat e Kosovës në tenderin e datës 26. 08. 2010 për ofrimin e shërbimeve mobile kanë shpallur fitues kompaninë "Z-Mobile" në tenderin publik ku në garë ishin edhe IPKO me PTK-në. Po ashtu edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm fitues të tenderit e ka shpallur operatorin virtual të PTK-së "Z-Mobile".

Drejtimesit e PTK-së vazhdojnë ta mbrojnë këtë kontratë të cilën e cilësojnë si të favorshme. Kryeshefi ekzekutiv i PTK-së e pranon se ka humbur në këto tenderë por thotë se "Vala" nuk ka sistem të faturimit dhe për këtë arsye nuk mund të fitojë në këso projektsh. Ai thotë se PTK-ja ka marrëveshje me "Z-Mobile" me anë të një aneks-kontrate që aty ku mund të hyjë kompania publike të fitojë kompania virtuale e jo operator tjetër, IPKO.

Mungesa e platformës së faturimit nxirret si një arsyetim i vazhdueshëm, nga përfaqësuesit e PTK-së, kur ata pyeten për arsyen e humbjes së tregut. Ata thonë se mungesa e kësaj platforme, i kufizon, sepse PTK-ja, për shërbimin "post-paid" ka një kapacitet faturimi vetëm për 20 mijë klientë.

Një kontratë, për ndërtimin e sistemit të faturimit për PTK-në, e pat fituar kompania angleze "Amdocs", por që anuluar nga ish-ministri i Financave, Ahmet Shala,





duke e ekspozuar kështu PTK-në ndaj një rasti gjyqësor në Gjykatën e Arbitrazhit në Londër. Drejtori i PTK-së, Shyqyri Haxha, thotë për “Preportr” se deri tani vetëm angazhimi i avokatëve për këtë rast ka arritur shumë prej 300 mijë eurosh. Platforma në tërësi ka kushtuar 20 milionë euro, dhe është anuluar nga ish-ministri Shala, nën arsyetimin se PTK gjendet në procesin e privatizimit dhe duhet të ndërprejë investimet e tilla.

Sido që të jetë, Haxha thotë se në një konferencë të investorëve në Prishtinë, kërkesa më e shprehur e Telekom Austria ka qenë pikërisht anulimi i disa projekteve, siç është platforma e faturimit. Mungesa e kësaj platforme, sipas drejtorit të PTK-së Haxha, ka bërë që “Z-Mobile” të jetë “shpëtimi” ndaj konkurrencës. “Ne kemi marrëveshje me ta që vendet ku ne nuk mundemi më i marrë, t’i marrin ata. Kemi marrëveshje. Mbi 95 për qind të konsumatorëve tanë janë pre-pid. Vetëm 5 për qind janë post-paid. Ne nuk kemi kapacitet të bëjmë faturimin. Ai sistem që e kemi ne i mbulon vetëm 20 mijë konsumatorë”, ka thënë Haxha. “Ne e kemi çu në 40 mijë dhe në çdo moment mundemi të kolapsojmë, të bllokohemi”.

“Z-Mobile e ka sistemin e vet të faturimit dhe mund të fitojë tenderë të tillë. Por edhe në këtë rast Z-Mobile investon për PTK-në”, thotë Haxha, i cili duket i kënaqur me mundësinë që Vala të marrë 27% të asaj që deri vonë e merrte të tërën.

Haxha thotë se edhe në këtë mënyrë kontrata është e volitshme për PTK-në.

Si shembull përmend kontratën në mes të “D3 Mobile” dhe “IPKO” të cilët pretendon se posedon një kopje të saj. “D3-shi” ka hapësirë për 300 mijë numra. Krejt produktet, çdo detaj ka me ia zhvillu ‘IPKO’. Ajo ka me ia zhvillu. Ne kemi marrëveshje me ‘Z-Mobile’ që konkurrencë të mos i bëjmë njëri-tjetrit. Hymë bashkë. Konsumatorët tanë nuk i merr”, thotë Haxha. Nga çdo minutë thirrjesh e shërbimesh tjera, PTK-ja sipas Haxhës merr 27 për qind. Bile edhe në thirrjet brenda “Z-Mobile”.

“Nuk shkruan në kontratë po na i marrim 27 për qind. Kjo ka arrit deri në 40 për qind. 27 për qindshin ne e marrim çdo herë. Sepse është trafiku jonë dhe regjistrohet trafiku”.

Tregu i lirë i ART-së

Mirëpo këtu nuk përfundojnë privilegjet për Z-mobile. Këtij operatori i mundësohet edhe nga ART të bëjë konkurrencë me uljen. Çmimi për një minutë kohë bisede në rrjetin “Vala” nga ky operator kushton 9 cent, ndërsa një minutë bisedë brenda rrjetit “Z Mobile” dhe drejtë “Vala-s” kushton vetëm 7 cent. “Z Mobile” i shet më lirë impulset telefonike se PTK, ndonëse të njëjtat i blenë nga operatori virtual. Po ashtu, shumë minuta bonus për konsumatorë “Z Mobile” i jep edhe për mbushjet për 5,10 dhe 20 euro, mirëpo këtë mund ta bëjë kompania publike e cila nuk jep asnjë minutë bonus për konsumatorë.

Çdo konsumator i “Z Mobile” që i blenë 5 euro mbushje i fiton automatikisht edhe 8

euro tjera falas, për mbushjen në vlerë prej 10 euro i merr edhe 20 euro falas, ndërsa për mbushjen prej 20 euro i fiton edhe 48 euro bonus. Arsyetimi i zyrtarëve të PTK-së, edhe në këtë rast, është mungesa e sistemit të faturimit.

Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit ka fuqi përcaktuese të çmimeve të telekomunikacionit në treg. Si treg të lirë e konsideron këtë konkurrencë ndërmjet “Z-Mobile” dhe “Valës”. Kontrata ndërmjet “IPKO-s” dhe “D3 Mobile” ndalon konkurrencën nga ana e operatorit virtual. Në një përgjigje më shkrim nga ART-ja, nuk mohohet se në treg ka ofertë më të lirë të “Z-Mobile” sesa ato të “Valës”.

“Vala si një operator i integruar vertikalisht ofron shërbime në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Konkurrenca që Z-Mobile i bën Valës në tregun me pakicë është e drejtë edhe synim i politikave ligjore dhe rregullatore të sektorit”, thotë ART.

ART sikundër edhe shefi i PTK-së, pyetjes se si është e mundur që një operator që blen impulsa nga operatori publik të jetë më i lirë në treg, i përgjigjen me retorikën e “përfitimeve të qytetarit”. “Nga këtu gjenerohet vlere për qytetarin, kur një pjese e surplusit nga operatorët/ofruesit e shërbimit kalon te qytetari për shërbime të njëjta me kualitet të njëjtë”, ka thënë ART-ja. Ata natyrisht nuk besojnë në magji, por thonë se përparësia e përdorimit të teknologjisë së re e bën të mundshme një gjë të tillë. Mirëpo, teknologjia që përdor Z-Mobile, në të vërtetë në aspektet kryesore është në pronësi të PTK-së, duke qenë se ajo është përdoruese e rrjetit të “Vala 900”

“Efektet kryesisht maten nëpërmjet vlerësimit të dobisë që e ka qytetari/konsumatori”, thotë ART, duke iu mënjauar diskutimit mbi atë se sa dëmtohet PTK me këtë kontratë.

Nga ana tjetër, Valon Basha, zyrtar ligjor në “Z-Mobile”, sikur edhe ART-ja dhe PTK-ja, mendon shumë për qytetarin. “Përfituesi më i madh i kësaj kontrate është qytetari i Kosovës, i cili për shkak të rritjes së konkurrencës përfiton”. Pasi thotë se këtu përfiton qytetari, Basha shton se “Z-Mobile” po vazhdon të operojë me humbje dhe kjo pritet të shkojë deri në vitin 2015, kur pritet të ketë fitime. “Përfitimet e PTK prej ‘Dardafon.net’ janë të shumëfishta, e që për vitin 2010 janë numra 7 shifror”, ka thënë Basha.

Injorimi i alarmit për kontratën

Kontratën e lidhur në mes të PTK-së dhe “Dardafon.net” e kanë kundërshtuar punonjësit e PTK-së të ngarkuar për vlerësimin e saj. Por këto vlerësime, nuk u morën parasysh nga Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje publike qysh në vitin 2008. Në bazë të kontratës së përpiluar, PTK-së i takojnë vetëm 27 për qind të hyrave nga shitja e shërbimeve nga “Z Mobile”, ndërsa kësaj të fundit i mbeten hiç më pak se 73 për qind.

“Grupi në mënyrë unike konstaton se oferta finale e ‘Dardafon.net’ me përqindje të ndarjes së të hyrave... nuk ka arsyeshmëri strategjike, e aq më pak komerciale për PTK”, thuhej në raportin që e kishin përgatitur ekspertët. Njëri nga ekspertët e PTK-së, i cili në atë kohë ishte kundër nënshkrimit të kontratës, jep arsyt pse nuk e ka përkrahur një kontratë të tillë.

“Kontrata është shumë e pafavorshme për ‘Valën’. Rentabiliteti për këtë të fundit ishte paraparë vetëm nëse përqindja do të ishte 73% në favor të ‘Valës’, ndërsa në bazë të kontratës së nënshkruar nuk mund të flitet për kurrfarë rentabiliteti”, thekson eksperti, i cili preferon të flas në kushte anonimiteti. Sipas këtij eksperti, përpjesëtimi i ndarjes së prezantuar në draft-marrëveshjen për MVNO, gjeneron zvogëlim të konsiderueshëm të të hyrave për ‘Vala’, ndërsa në disa kategori të produkteve gjeneron humbje si: Trafiku ndërkombëtar në shkuarje, kjo duke marrë parasysh çmimin e minutave për njësi.

PTK-së, sipas këtij raportit, kjo kontratë do t’i gjeneronte humbje të pashmangshme, pasi që modeli i përzgjedhur për MVNO nuk obligon operatorin virtual të llogaris të hyrat totale të muajit, por të hyrat e mbledhura, duke përjashtuar borxhet e këqija që do të vijnë si rezultat i mospagesës së faturave nga konsumatorët e MVNO.

Shqetësimi më i madh i ekspertëve është pikërisht për shkak se pagesat e shërbimeve të pranuar nga “Vala”, ku është paraparë që pagesa të ekzekutohet nga “Dardafon” çdo 4 muaj, nuk mund të justifikohet assesi, posaçërisht në rastin e pagesave për konsumatorët me parapagim.

Në asnjë prej neneve të kontratës, që është vetëm në gjuhën angleze e nënshkruar nga shqiptarë, në mes të PTK-së dhe operatorit virtual Dardafon.net, nuk është specifikuar pragu i cili do të ndalonte operatorin virtual të operonte me oferta më të lira sesa PTK-ja. Kjo për ekspertët është gabimi më i madh që po i kushton kompanisë publike.

PTK-ja po ashtu kishte bërë gabimin në hapa, kur bënte plane t’ia shiste kapacitetet një operatori tjetër, ndonëse ky operator që është në duar të privatëve synonte tregun e njëjtë. Për këtë kanë dhënë vërejtje edhe ekspertët ndërkombëtarë në lidhje me marrëveshjet për operator mobil virtual. Sipas ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët janë cituar në këtë raport, nuk paraqet zgjuarsia për një operator shitja e kapaciteteve një operatori tjetër, nëse ky i fundit ka për synim tregun e njëjtë, apo segmentimin e njëjtë të tregut. Ata rekomandonin që qasje strategjike më e mirë do të ishte sikur PTK-ja të shfrytëzonte operatorin virtual për të ofruar shërbime, të cilat operatorin nuk i konsideron shërbime të dorës së parë.

Projekti kombëtar në telefoninë mobile: si dështoi?

Siç ua pati ënda

Çfarë ndodhi me kompaninë e përbashkët Shqipëri-Kosovë në telefoni mobile – të iniciuar nga kryeministrat e këtyre dy vendeve? Si u tkurren aksionet e PTK-së në “Plus” për dhjetë fish? A ishte ky një projekt që ia shtoi vlerën PTK-së, siç u proklamua në Prishtinë, apo thjesht një nismë bashkëpunimi mes të dy kryeministrave që të përfitojnë nëpërmjet retorikës patriotike?

Preportr – Operatori i katërt i telefonisë mobile në Shqipëri është marrë në emër të PTK-së. Pasi e proklamuan si një projekt që do të ndryshojë praktikën e nxjerrjes së parasë jashtë vendit nga ky sektor shumë profitabil, kryeministrat, Berisha e Thaçi, morën përsipër që në mënyrë indirekte të ndërtojnë një operator të përbashkët në telefoninë mobile. Më pak se një vit nga fillimi i punës së këtij operatori u bë e qartë se PTK u shfrytëzua vetëm si emër për të shtuar pikët në tenderin për operatorin e katërt.

Një konsorcium i formuar ad-hoc, ka bashkuar PTK-në me disa biznese dhe individë nga Shqipëria, për të fituar licencën për operatorin e katërt të telefonisë mobile në Shqipëri.

Kjo ndërmarrje e Qeverisë së Kosovës, e mbyllur pothuajse tërësisht për publikun, ka premtuar një pjesëmarrje të PTK-së me 30% në këtë projekt, por sapo ka filluar implementimi i projektit, aksionet e PTK-së janë zbritur për dhjetë fish, pra nga 30 % në 3%.

Nga dokumenti për themelimin e konsorciumit kuptohet se Qeveria e Kosovës e ka pasur të qartë qysh prej fillimit se PTK-ja obligohet që të investojë jo vetëm në marrjen e licencës, por edhe në zhvillimin e mëturshëm të kompanisë. Fillimisht, Qeveria e Kosovës e ka shtyrë PTK-në në këtë biznes, duke i dhënë 2.4 milionë euro për të plotësuar ofertën prej 7.2 milionë eurove sa ky konsorcium ka ofruar për marrjen e licencës. Kjo u proklamua se i siguroi PTK-së 30 % të aksioneve në operatorin e katërt të telefonisë mobile të Shqipërisë. Më vonë, pasi “Plus” bëhet një kompani e licencuar dhe operative, në vend se të kishte një rritje të vlerës së investimit në para, “brand” dhe në “know how” të PTK-së, Qeveria e Kosovës ndërroi mendjen dhe vendosë të mos lejojë PTK-në të kryej investimet që kërkohen për këtë operator.

Ky investim, sipas zyrtarëve të PTK-së, mund të kapte një shumë prej 20 milionë eurosh, si fazë e parë e investimeve, që në total ishte llogaritur diku pak mbi 60 mil-

ionë euro, por që potencialisht mund t’i sillte PTK-së të hyra shumë më të mëdha dhe posaçërisht t’ia rriste vlerën në privatizim, ashtu siç kishin pretenduar zyrtarët e Qeverisë së Kosovës në fillim të kësaj iniciative. Kjo pasi që praktikisht Vala do të mund të konsiderohej se tashmë është pjesë e një tregu përtej kufijve të vendit. Sido që të jetë, me të marrë licencën, “PLUS” ia kthen PTK-së paratë e investuara dhe me këtë ia merr edhe 27 % të aksioneve, duke e reduktuar atë nga aksionarin kryesorë në një pjesëmarrës simbolik në aksione me vetëm 3%. Procedura me të cilën është bërë ky evaluim dhe veprim është tërësisht e paqartë si shumëçka në lidhje me këtë operator.

Megjithatë në kuptimin e investimeve dhe pjesëmarrjes në aksione PTK-ja praktikisht ka marrë një profil tepër të ulët, duke thënë se vetëm në baza preferenciale i janë lënë kësaj kompanie 3% të aksioneve, PTK-ja gjithmonë para publikut është shfaqur si aksionar i rëndësishëm në këtë operator. Me dhënien e licencës këtij konsorciumi, në komunikatat e para të dala nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit i Shqipërisë, PTK-ja është konsideruar si fitues i tenderit. Në anën tjetër, në një komunikatë të lëshuar nga PTK-ja, më 31 maj 2010, nuk jepet asnjë informacion se PTK-ja nuk ka bërë investimet e duhura në këtë operator, por lihet të kuptohet se aksionarët tjerë do të investojnë. Në këtë komunikatë vetëm thuhet se “PTK është në rrugë të mirë të bëhet lider në rajon në përputhje me vizionin dhe misionin e saj”.

Privatizimi i PTK-së arsyetim për tërheqje:

Kryeshefi ekzekutiv i PTK-së, Shyqyri Haxha, këtë tërheqje e arsyeton me priva-

tizimin e PTK-së. Ai thotë se Bordi i Drejtorëve dhe qeveria nuk e kanë parë të nevojshme të investohej më jashtë vendit. Fjala është për pak më shumë se 20 milionë euro investim shtesë që do t’ia ruante PTK-së aksionet në “Plus”, në fazën e parë të investimeve.

Në atë kohë, pra në periudhën 2008-2010, Qeveria e Kosovës ka marrë në formë të dividendës nga PTK vlera shumë më të mëdha se sa duhej për t’ia ruajtur aksionet në tregun shqiptar. Qeveria Thaçi njëherë i kishte marrë 200 milionë euro buxhetit të PTK-së e më vonë edhe 80 milionë euro tjera.

Patriotizmi: 3% loaded

Prania e një kompanie të telefonisë mobile në një treg tjetër jashtë vendit, njihet si një përparësi e jashtëzakonshme në tregun e telefonisë mobile. Ky fakt praktikisht shndërron kompaninë nga një kompani me biznes lokal, në një kompani që kapërcen kufijtë nacional dhe për investitorët në këtë sektor vetëm ky fakt ndryshon perceptimin në kuptim pozitiv. Pse atëherë ka një tërheqje nga projekti “Plus”, nëse Qeveria, siç është shprehur në nismën e këtij projekti, ka qenë aq e bindur se ky investim do t’ia shtojë vlerën PTK-së? Nga kompania “Plus” nuk është dhënë asnjë sqarim në lidhje me këto veprime, përkundër insistimit tonë disa mujor.

“Preportr”, po ashtu ka bërë përpjekje të vazhdueshme, disa javore që të kontaktojë Ministrin për Zhvillim Ekonomik, për të sqaruar këtë gjë, mirëpo kjo ka qenë e pamundshme pasi Ministri Beqaj, rregullisht ka refuzuar takimet me arsyetimin e agjendës së ngjeshur.

Nga të gjitha dokumentacionet e siguruar dhe intervistat e bëra nga “Preportr” kuptohet se ky proces është koordinuar nga niveli kryeministral. Vendimi që gjendet në arkivin e Qeverisë së Kosovës,

me nënshkrimin e Kryeministrit Hashim Thaçi, thotë: “...miratohet kërkesa e Bordit të Drejtorëve të Postës dhe Telekomit të Kosovës mbi mundësinë e zgjerimit të veprimtarisë së saj edhe në tregun e Shqipërisë – pjesëmarrjen në tenderin për licencën e katërt të telefonisë mobile në Shqipëri”.

Në anën tjetër kryeshefi ekzekutiv i PTK-së, Shyqyri Haxha, tregon për një ujdi mes dy qeverive, asaj në Tiranë dhe asaj në Prishtinë, e cila madje ishte arritur edhe para se të hapej ky tender. “Shteti shqiptar ka dashur një kompani të vendit që do e mbante fitimin në Shqipëri pasi tre operatorët e tjerë nxjerrin shumën e mëdha jashtë shtetit”, thotë Haxha. Kjo ndoshta shumë më tepër tregon se Qeveria e Shqipërisë e kishte marrë vendimin qysh para nisjes së procedurave të tenderit se kush do jetë fituesi. Sidoqoftë, ajo që ndodh me kalimin e kohës nxjerr në shesh vendime të cilat iu vënë pikëpyetje përfitimeve të PTK-së nga ky projekt.

Cilët janë aksionarët e “Plus-it”?

Duket se qëllimi asnjëherë nuk ka qenë që PTK-ja të futet në tregun shqiptar, të paktën jo aq i rëndësishëm sa qëllimi për t’ua mundësuar tjerëve një gjë të tillë. Në mesin e atyre që u është krijuar mundësia të nisin biznesin në tregun e telefonisë mobile nuk janë vetëm kompanitë, por edhe personat fizik.

Një dokument që e ka siguruar “Preportr” tregohet saktë se kush janë aksionarët e “Plus-it” shqiptar. Dokumenti themelues i konsorciumit që mori licencën për operatorin “Plus” tregon ndarjen e aksioneve qysh ishte në fillim, pra atëherë kur PTK kishte ende 30 % të aksioneve.

Ky dokument thotë se Union Group dhe ACI Engineering kanë nga 12.5 % të ak-



sioneve. Më tej në të njejtin dokument thuhet se Albania Drink Distributtion ka 16.0 % të aksioneve dhe Infosoft Systems Sh.A ka vetëm 4 % të aksioneve. Sidoqoftë pjesa më interesante e këtij dokumenti është fakti që Saimir Mane – me seli në Qendrën Tregtare Universe (periferi e Tiranës) del të jetë pronar i 25 % të aksioneve të “Plus”-it.

Në vitin 2008, si person fizik, shumë shpejt pasi që i kishte shitur një qendër tregtare biznesmenit të njohur serb Miroslav Mishkoviq, Mane u fut në një konsorcium me operatorin publik Vala, gjegjësisht PTK-në, e vlerësuar atë kohë rreth një miliardë euro.

Në dokumentin për themelimin e konsorciumit për operatorin e katërt në Shqipëri thuhet se Mane ka qendrën në QTU edhe pse pas një transaksioni të njoftuar në Shqipëri kjo qendër i ishte shitur Delta Group, e themeluar nga Mishkoviq, ish-zv.kryeministër i Serbisë në kohën e Millosheviqit. Në këtë “projekt kombëtar”, PTK-ja nga statusi i aksionarit kryesor, me më së shumti aksione, prej 30%, tani është aksionar jorelevant. Në aspektin ligjor është e vështirë të kuptohet se cila ishte procedura që përcaktoi rënien për plot 27 pikë të aksioneve. Zyrtarët e PTK-së thonë se madje edhe tre përqindëshi i ngelur i aksioneve është rezultat i zemërgjerësisë së “Plus-it”. Në anën tjetër në një komunikatë për shtyp, PTK-ja thotë se ka investuar “në të ashtuquajturin model ‘Know How’, edhe pse asnjëherë nuk është raportuar se cila ka qenë vlera e “know how” dhe e aseteve tjera të PTK-së të futura në këtë konsorcium, siç është për shembull brandi, apo edhe ekspertiza.

Shyqyri Haxha, Shef Ekzekutiv i PTK-së, shprehet se pasi që fillimisht i janë marrë PTK-së aksionet, ‘Plus’ i ka ofruar PTK-së që të blejë sërish aksione. “Tani ato aksione janë shtrenjtuar”, thotë ai.

“Plus” minus PTK

Në anën tjetër të kufirit, përfshirja e PTK-së në operatorin e katërt të telefonisë mobile të Shqipërisë pothuajse nuk ekziston fare, edhe pse ajo ishte vendimtare për licencimin e kompanisë. “Preportr” ka bërë dhjetëra përpjekje përmes telefonatave apo postës elektronike që të caktojë një intervistë me përfaqësues të “Plus” në Tiranë, por kjo ka qenë e pamundur. Në momentin e publikimit të lajmit për fitimin e licences në Tiranë në plan të parë del PTK-ja si operator i katërt, duke nxjerrë nën hije biznesmenët e afërt me qeverinë shqiptare, të cilët dukej se nuk ankoheshin për këtë.

Situata ndryshon me t’u konsumuar interesimi i parë i publikut mbas funksionalizimit të operatorit “Plus”. Në faqen e internetit të “Plus”, komunikata e parë për media e kësaj kompanie nuk e thotë asnjë fjalë për PTK-në. “Kompania u themelua më 26 Qershor 2009... PLUS i është akorduar licenca e GSM-së pas ofertës më të lartë prej 7.2 milionë eurosh në tenderin ndërkombëtar mbajtur më datë 23 Janar

2009”, thuhet në faqen e internetit të operatorit shqiptar të telefonisë mobile. Në një nga bisedat e shumta telefonike me zëdhënësen e “Plus”, Jonilda Filipi, kjo e fundit vetëm e ka konfirmuar se “PTK ka aksione të saj në këtë kompani”, pa thënë asnjë detaj rreth përfshirjes apo rëndësisë që PTK ka në operatorin e katërt të telefonisë mobile në tregun shqiptar.

Dividenda në fund të vitit

E vetmja gjë që thuhet rreth tërheqjes së fitimeve të PTK-së, nga ajo që i ka mbetur në “Plus” nuk është shuma e parave sa kanë marrë deri më tash, por vetëm fakti se ato tërhiqen në fund të çdo viti. Sipas përfaqësuesit të PTK-së në “Plus”, Elvis Pista, “çdo shoqëri aksionare e ndan dividendën në fund të vitit”, dhe kjo sipas tij vlen edhe për PTK-në. Pra kjo i bie që nëse supozohet se fitimi vjetor i “Plus” është 100 milionë euro, atëherë 300 mijë eurot që i takojnë PTK-së mbesin në llogarinë bankare të operatorit të katërt të telefonisë mobile të Shqipërisë deri në fund të vitit duke pamundësuar kështu operimin e këtij keshi nga kompania publike kosovare përgjatë tërë vitit.

Në fakt, zyrtarët e intervistuar të PTK-së e përsërisin pandërprerë se PTK-ja në “Plus” e ka statusin e të privilegjuarit”, diçka që asnjëherë nuk është konfirmuar nga zyrtarët e “Plus” në Tiranë dhe as me ndonjë të dhënë apo dokument solid. Sidoqoftë, ajo që duket se i siguron PTK-së “statusi i të privilegjuarit”, sipas Pistës,

është se PTK-ja mund të kërkojë auditim të brendshëm apo të ketë qasje në çfarëdo forme apo elementi të “Plus”.

Çka për kosovarët?

Në njoftimet për shtyp dhe në intervistat e dhëna për “Preportr”, përfaqësuesit e PTK-së refuzojnë që të flasin në terma absolut për çmimet që do paguajnë konsumatorët e Vala kur shfrytëzojnë rrjetin e “Plus” edhe pse insistohet se këta konsumatorë do të kenë një trajtim preferencial. Informacioni i PTK-së i dhënë për operatorin “Plus” është i gjerë, por në asnjë moment nuk hedhet dritë mbi tarifat e vërteta që konsumatori do paguaj.

Në ditën e lansimit të “Plus”, që u zgjodh të ishte dita e flamurit kombëtar 28 nëntori, shefi i PTK-së, Shqyryqi Haxha thotë se çmimet me operatorin ‘Plus’ do të jenë 200% më të lira se ato ekzistueset.”

“Një verë me çmime shumë më të lira në aspektin e komunikimit, do të ofrojë Postë Telekom i Kosovës si aksionar në operatorin e katërt në Shqipëri”, thotë PTK në Maj të vitit 2010. Në anën tjetër, “Plus” kurrë nuk ka lëshuar ndonjë informacion për tarifat që konsumatorët e Valës do të paguajnë kur përdorin rrjetin e këtij operatori.

Një reklamë e PTK-së, porositë konsumatorët e vet që të lidhen me operatorin “Plus”. “Lidhu...lidhu me Plus”, përmes së cilës dy vajza të bukura “magjepsnin” kosovarët gjatë periudhës së verës në reklamë që transmetohej në televizionet e Kosovës.

No.	Member Name	Percentage	Concrete Elements
1	PTK	30%	Takes over the implementation in collaboration with other executive members of the Project. Also takes operator assistance and know-how regarding the technical aspects, operational, and training of staff and others. Depending on the needs for funding, takes funding in collaboration with members of other funding to cope with all the costs of design and implementation of works.
2	UNION GROUP	12.5%	Takes over funding in collaboration with members of other funding to cope with all the costs of design and implementation of works. Takes over the implementation in collaboration with other executive members of the Project.
3	Albanian Drink Distribution	16%	Takes over the networks distribution of the products that will hit the market. Takes over the realizations of the cooperation in between the other members of the Project.
4	Samir Mane	25%	Takes over funding in collaboration with members of other funding to cope with all the costs of design and implementation of works.
5	ACI Engineering	12.5%	Takes over all contacts with domestic and foreign producing and trading companies, for ordering and purchasing of all machinery, electrical and hydro technical equipment, as well as negotiations or representation of this group, in drafting the project to be implemented and follow-up procedures until the construction permit is granted. Takes over the implementation in collaboration with other executive members of the Project.
6	INFOSOFT SYSTEM	4%	Takes over all contacts with domestic and foreign producing and trading companies, for ordering and purchasing of all machinery, electrical and hydro technical equipment, as well as negotiations or representation of this group, in drafting the project to be implemented and follow-up procedures until the construction permit is granted.

Dokumenti: Marrëveshja e Unionit të Investitorëve - Shpërndarja e aksioneve në mes investitorëve për operatorin e telefonisë mobile “PLUS”.

Përmes kësaj “magjie”, PTK-ja u premton kosovarëve çmime më të lira kur e vizitojnë Shqipërinë. Kjo nuk është konfirmuar asnjëherë nga “Plus” edhe pse ka mbi një vit që funksionon ky operator.

Shefi i zyrës për informim në PTK, Menduh Abazi, thotë se hyrja e PTK-së në tregun shqiptar është bërë me qëllim që të ketë: “Çmime më të lira për të gjithë konsumatorët e Vala-s që hyjnë në Republikën e Shqiperisë dhe marrja e ‘statusit të privilegjuar’. Mirëpo kur pyetet se si mund ta konfirmojmë këtë Abazi citon teoricienin e famshëm të tregut të lirë Adam Smith duke mos dhënë asnjë çmim për një produkt të caktuar.

Çështja e statusit të privilegjuar nuk është konfirmuar asnjëherë nga përfaqësuesit e “Plus-it” në Tiranë, ndërsa edhe kur janë në pyetje çmimet më të lira për kosovarët që udhëtojnë në Shqipëri, kjo nuk qëndron gjithashtu.

Kur PTK flet për çmimet me “Plus” zakonisht përdor një metodë jo të zakonshme në këtë treg. Zakonisht jepen përqindje, por operatorët e telefonisë mobile në marketingun promovues të tyre dhënë çmime gjegjëse për produktet specifike. PTK-ja mjaftohet duke thënë se mesazhet telefonike do të kushtojnë 50% më lirë. Një verifikim i gazetarëve të “Preportr” ka treguar se as kjo nuk qëndron. Një vizitë në Shqipëri e tregon që kosovarët me SIM kartela të Vala 900, e që lidhen me rrjetin e “Plus-it”, paguajnë çmime të njëjta sikur me operatorët e tjerë, p.sh. Eagle Mobile apo Vodafone. Nëse lidhesh me “Plus” dhe dërgon një mesazh telefonik, një klienti kosovar i harxhohen 0.40 euro, njëjtë siç ndodhë edhe kur je i lidhur me operatorët të tjerë.

Më herët me Vala 900, për shërbimet me roaming, nga Shqipëria është paguar 1.95 euro, ndërsa tani paguhet 0.50 euro për thirrjet drejt Valës dhe Telekomit të Kosovës (linjës tokësore).

Abazi thotë se tani me Plus-in, mesazhet telefonike janë 50 % më lirë, megjithëse nuk e tregon sakt se sa janë ato çmime.

Përpos kësaj, edhe nëse klientët e Vala 900 duan të lidhen me rrjetin e “Plus-it”, kjo gjë është shumë e vështirë pasi operatori i katërt i telefonisë mezi gjendet në listën e operatorëve. Zyrtarët të PTK-së, jo zyrtarisht e kanë arsyetuar “Plus-in” se instalimi i antenave ka shumë pak kohë që ka filluar dhe hapësira që e mbulon tani ky operator në territorin shqiptar është mjaft e madhe në krahasim me kohën që e kanë pasur.

Kjo kompani pothuajse nuk ka fare rrjet përgjatë një pjesë të bregdetit shqiptar, e bregdeti mbetet ndër arsyet kryesore të vizitave të kosovarëve në Shqipëri. Duket se kjo është arsyeja pse zyra për informim e “Plus-it” në Tiranë nuk pranoi të flas fare për atë se sa përqind të territorit shqiptar mbulojnë antenat e tyre.

Është lehtë e kuptueshme që formulës së PTK-së :“Lidhu...lidhu me Plus” i mbaron magjia në momentin që kosovarët dalin në territorin shqiptar, pasi të verifikojnë edhe vet se sa vërtetë kanë harxhuar gjatë telefonatave apo dërgimit/pranimit të sms-ve ■

VIJON NGA FAQE 5

E mbrojnë kontratën

Kryeshefi i PTK-së, kurrsezi nuk pajtohet që PTK-ja ka humbje. Përkundrazi ajo po shënon rritje. Sipas tij, nuk ka asnjë shenjë që ka humbje. Bile kjo rritje po ndodh edhe për shkak të operimit të MVNO-së. Haxha mbrohet në procesin gjyqësor duke thënë se kontrata ishte bërë nga Bordi para se ai të vijë në PTK, por bie në kontradiktë kur thotë se kontratën me “Dardafon.net” e kanë kundërshtuar njerëz që kanë pasur synim të hyjnë vetë në treg.

Për këtë akuzon ish-kryetarin e Bordit të PTK-së, Ilir Salihun, ish-shefin se sektorit të çështjeve ekonomike në ICO, Andrea Capusellën dhe ish-kryeshefin e PTK-së, Etrur Rustemin se kanë punuar në mënyrë intensive që ta marrin vetë këtë treg. “Plani tjetër është që Tibor Kartik (këshilltari i qeverisë për privatizimin e PTK-së v.j.) ka konkurruar dhe ka dashtë me marrë po nuk kanë mundur. Ky është

një aversion i kompanive të huaja, që ata të vijnë dhe ta marrin yndyrën dhe paranë e popullit tonë këtu”.

Sipas Haxhës, asnjë prej 150 mijë konsumatorëve që ka “Z-Mobile”, nuk janë konsumatorë të ikur nga “Vala”, por konsumatorë të rinj të një tregu që ka qenë i zbrazët.

Madje, zyrtarë në PTK, tregojnë për Preportr që në takimin e parë, në mes PTK-së dhe Këshilltarit të Transaksionit për privatizimin e PTK-së, Tibor Kartik nga Telco AG, nga ky është kërkuar të dihet se cilat janë kushtet dhe mundësitë e shkëputjes së kontratës në mes PTK-së dhe Dardafone.net, përkatësisht Zmobile. “Në takimin e parë që kemi pasur me Këshilltarin e Transaksionit, nga ai është kërkuar të dihet se cilat janë mundësitë e shkëputjes së kontratës me Zmobile”, thotë për Preportr ky zyrtar i PTK-së.

Por ish-kryeshefi i PTK-së, Etrur Rustemi, nuk dëshiron të merret me Haxhën. Ai thotë se dëmshmëria e kontratës nuk do koment

por është e dokumentuar sepse është dashur që 70 për qind të jetë në favor të “Valës”.

Pika më e keqe e kësaj kontrate sipas tij është raporti i ndarjes se fitimit, lejimi i paketave konkurruese në vetë PTK-në dhe mashtrimet që “paskan pas ndodhë me ndërrimin e firmave”.

Paraardhësi i Haxhës nuk e kishte nënshkruar kontratën

Sabahudin Ramaxhiku i cili ushtronte detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv, ishte i ngarkuar nga Bordi i PTK-së që të nënshkruante kontratën për operator virtual. Ai kishte refuzuar ta bënte këtë në mënyrë që të mos prishë obligimet e mirëbesimit ndaj PTK-së. Sipas dosjes së Prokurorisë Speciale të Kosovës, Blerim Devolli i kishte bërë një vizitë Ramaxhikut për t’u interesuar rreth arsyeve pse marrëveshja nuk ishte nënshkruar ende. Ramaxhiku i kishte thënë Blerim Devollit se nuk ishte i kënaqur me marrëveshjen dhe se nuk do ta nënshkruante.

Gjatë kësaj kohe PTK-ja kishte shpallur konkurs për pozitën e kryeshefit.

Nuk e pranojnë Z-mobile

Blerësit potencial të PTK-së, kanë thënë që ose të prishet kontrata e nënshkruar me Z-mobile ose përndryshe me kushtet që i ka kjo kontratë nuk është pajtuar asnjëri prej tyre. Kështu ka bërë me dije burimi brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomi. Ky burim ka sqaruar se është duke u shqyrtuar mundësia me këshilltarët ligjorë se çfarë të bëjnë me këtë Kontratë. “Kur po i shohin detajet e kontratës nuk ka gjasa që të pajtohen me të. Kanë kërkuar që nëse nuk lejohet prishja e kontratës, të paktën të ndryshohet aneksi ku flitet për ndarjen e fitimit”.

“Nuk ka asnjë mundësi që të pranohet kontrata e tillë me 70 % fitim Z-mobile e 30 % PTK-ja, ai që privatizon PTK-në, s’do ta pranojë këtë Kontratë, përdërisa të kthehet përqindja e fitimit anasjelltas”, ka bërë me dije burimi brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ■

Dosja

Kjo gazetë, e katërta me radhë e botuar nga Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese, përmban disa raporte hulumtuese mbi njërin prej sektorëve më fitimprurës në Kosovë, telekomunikacionin, dhe specifikisht kompaninë më fitimprurëse kosovare, PTK-në. Është një dosje që tregon se si ndodhi që kompania me qarkullim vjetor prej rreth 200 milionë eurosh ka mundur të shitet me një çmim mes 120 e 300 milionë euro. Si është e mundur kjo?

Në këtë gazetë, ka informacion që i përgjigjet në masë të madhe kësaj pyetje. Përgjigjja mund të jetë e thjeshtë. Kjo ka ndodhur para së gjithash për shkak të përfshirjes së konfliktit mes interesave të sektorit privat e politikës në njërin anë, me interesat publike në anën tjetër. Ky konflikt ka ndodhur në vazhdimësi dhe ka pikëtakim me momente tjera të rëndësishme të zhvillimit të sektorit të telefonisë mobile në Kosovë. Historia fillon pak a shumë me tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile të mbajtur më 2004 dhe të përsëritur më 2007.

Siç do ta shihni këtu ka shumë informacione e evidenca të cilat nuk kanë qenë të njohura për publikun më herët, por ka edhe informacion që në mënyrë të shpërndarë janë botuar gjatë këtyre viteve pa u vendosur në një kontekst të integruar për ta treguar tërë të vërtetën mbi këtë sektor. Së pari, reduktimi skandaloz i vlerës së kompanisë më të madhe kosovare është arritur falë

korupsionit të përmasave ndërkombëtare. Siç do ta shohim, në sektorët më fitimprurës, sidomos në privatizime dhe prokurime të rëndësishme, ka një bashkëim mes bosave vendor dhe atyre ndërkombëtar. Përfshirja hap-tazi në konflikte interesi e kompanive ndërkombëtare, ka hasur një vëmendje të pamjaftueshme edhe nga opinioni kosovar edhe nga ai ndërkombëtar.

Për shumë vite është krijuar disi ideja se korupsioni dhe konflikti i interesave mund t’iu atribuohet vetëm vendorëve dhe kur kemi hasur në të tilla veprime të kompanive e zyrtarëve ndërkombëtar sikur nuk kemi pasur përkushtimin e mjaftueshëm për ta hulumtuar e ekspozuar më tutje. Kjo njëanshmëri ndoshta ka burimin nga inferioriteti gjeneral që ushqehet ndaj ndërkombëtarëve në Kosovë, apo mosbesimi se ne jemi të aftë për ta kuptuar dhe ekspozuar kur një kompani e huaja futet në marrëdhënie joligjore dhe në korupsion. Shpesh këtë injorim e ka shkaktuar edhe fakti se mbrapa këtyre rasteve janë shfaqur emra të mëdhenj ndërkombëtar të diplomacisë dhe të botës së konsulencës. Këta faktorë bashkë janë shumë të frikshëm për mediat e gazetarët vendor, kurse janë të paprekshëm për shoqërinë civile të vendeve të vogla, që indirekt i takojnë grupeve të njejtë të interesit me kompanitë konsulente që angazhohen në projekte të rëndësishme.

Pse ta zëmë ka qenë e mundur që në punët e mëdha të qeverisë të ketë

monopol një kompani e caktuar konsulence? Si është e mundur që një kompani njëkohësisht të iniciojë raste kundër autoriteteve kosovare dhe të fitojë punë nga po këto autoritete? A krijon kjo marrëdhënie një potencial të punës nën shantazh ndaj autoriteteve kosovare?

Një aspekt tjetër i tërë këtij hulumtimi është historia e marrëdhënieve që patën si rezultat një rënie drastike të çmimit potencial të kompanisë më të vlefshme kosovare, PTK-së. Qeverisja nën raporte të korruptuara të tenderit për operatorin e dytë të telefonisë mobile, më 2007, ka krijuar marrëdhënie varësie të autoriteteve kosovare ndaj kompanive konsulente që përfaqësuan kompanitë ndërkombëtare. Kështu për shembull kompania ndërkombëtare WolfTheiss më 2007 ka qenë përfaqësuese e Telekom Austria në tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile. Po kjo kompani pasi që kishte filluar disa procedura gjyqësore u zgjodh nga ish-ministri i financave, Ahmet Shala, që ta këshillojë qeverinë për privatizimin e PTK-së. Nuk ishte e rastit, prandaj, që Telekom Austria të ngelet si opcioni i vetëm për ta blerë PTK-në në fund të tenderit për privatizimin e PTK-së dhe ka qenë vetëm tërheqja e ofertuesit tjetër, Hrvatski Telekom, thembra e akilit për të ekspozuar këto konflikte në këtë tender.

Në anën tjetër PTK është reduktuar në vlerë për shkak të kontratave tjera të

bëra nga qeveria në emër të saj. Kontrata me Dardafone.net, e cila prodhoi disa raste për gjykatë, është parë si një arsye tjetër e reduktimit të vlerës së PTK-së. Po ashtu futja e PTK-së në tregun e telekomunikacionit në Shqipëri u promovua si një nismë patriotike, por përfundoi me një konzorcium të dyshimtë dhe me reduktimin e aksioneve të PTK-së për dhjetë herë menjëherë pas marrjes së licencës si operator i katërt në Shqipëri.

Kjo gazetë, bashkë me shumë raporte tjera nga shtypi kosovar, mund të shërbejnë thjesht si një dosje e mirë për prokurorinë dhe policinë po të kishte një pavarësi të tyre. Kjo gazetë do duhej sidomos t’iu shërbente partive politike kosovare, edhe atyre në pushtet, edhe opozitës, për ta parandaluar një ndërmarrje tjetër të Qeverisë, gjegjësisht asaj pjese të pushtetit që është kapur nga interesa të sektorit private në shitjen e kompanive publike me një çmim shumë më të ulët se ai i tregut. Një fokusim në këtë proces i politikës kosovare do të mund ta shpëtonte kompaninë më të vlefshme që ka Kosova, PTK-në, nga gllabërimi grupeve të interesit që për vite me radhë e kanë futur qeverinë kosovare në marrëdhënie të varësisë me ta, por do të krijonte një potencial për të ruajtur edhe tjetrën në radhë, KEK-un dhe përgjithësisht sektorin e energjisë ■

Preportr, Nëntor 2011